



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 1 qershor 2023, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese zgjodhën njëzëri Gjykatësin Stensland si Kryegjykatës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për një mandat njëvjeçar duke filluar nga 1 qershori 2023.

Më 2 qershor, ZPS-ja njoftoi me një komunikatë për shtyp se znj. Kimberli Uest, ish-Prokurore Federale në SH.B.A, me shumë përvojë si në hetimet penale vendase dhe ndërkombëtare, është zgjedhur Prokurore e Specializuar në vijim të procesit të organizuar nga Bashkimi Evropian.

Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova në një komunikatë për shtyp përgëzoi znj. Uest për emërimin dhe shprehu besimin se ajo "do të kontribuojë qenësishëm për përmbushjen efikase të mandatit të kësaj Zyre." Gjykatëse Trendafilova po ashtu theksoi se me emërimin e znj. Uest, DHSK-ja dhe ZPS-ja aktualisht kanë tri drejtuese femra, që tregojnë përparimin që po bëhet në fushën e të drejtës penale ndërkombëtare.

Më 6 qershor 2023, Trupi Gjyqësor I urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Shala. Trupi Gjyqësor konstatoi se ekziston ende rreziku që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor ose të kryejë krime të tjera. Trupi Gjyqësor konstaton më tej se këto rreziqe mund të zbuten mjaftueshëm vetëm me anë të kornizës së monitorimit të komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së.

Në të njëjtën çështje gjyqësore dhe pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të shtatë të martën, seancat përfunduan për këtë javë. Seanca vijuese në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të premten, 16 qershor, në orën 9:30 të paradites.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, Trupi Gjyqësor II më 6 qershor rrëzoi kërkesën e ZPS-së për t'i tërhequr vërejtje bashkëmbrojtësit të z. Thaçi, z. Dastid Pallaska, për deklaratat publike të bëra në një program televiziv. Trupi Gjyqësor konstatoi se deklaratat e z. Pallaska për kanalin televiziv të Kosovës, RTK, "ndonëse shpesh të pabazuara dhe të pasakta", nuk ishin përpjekje për të çorientuar qëllimisht publikun apo për të ndikuar në vendimin e Trupit Gjyqësor dhe as nuk u nxor informacion konfidencial.

Sa i përket deklaratës së pavërtetë të z. Pallaska se UÇK-ja është në gjykim, Trupi Gjyqësor bëri me dije se do t'i konsiderojë deklaratat e ardhshme publike të mbrojtësve, kur thonë se UÇK-ja është në gjykim, si deklarata që bëhen me vetëdije në kundërshtim me deklaratat gjyqësore.





Trupi Gjykes gjithashtu udhëzon mbrojtësin kryesor të z. Taçi të njoftojë për këtë vendim z. Pallaska dhe u kujton bashkëmbrojtësit dhe anëtarëve të tjerë të ekipit detyrimet në bazë të Kodit të Etikës dhe Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjyimit dhe bën paralajmërim, nëse është e nevojshme.

Seanca vijuese në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënë, 12 qershor në orën 9:00.

Pyetje nga gazetarët

